
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2025

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT**

03.07.2025

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “**MEKTRIN MOTORS**” shpk, me NUIS: **K51408501P**, me
adresë: “*DURRES AUTOSTRADA KM.6 XHAFZ.*”.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur, mbi kufirin e lartë monetar.

Referenca e Lotit: REF-47464-05-09-2025.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje zjarrfikse dhe automjete shërbimi Pick Up për ARRSH”, me afat zbatimi brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 12.05.2025.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 25 datë 19 Maj 2025.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “ARTEO 2018” SH.P.K

L82523203F

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 87,600,000 (tetëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind mijë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. “MEKTRIN MOTORS” SH.P.K

K51408501P

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 79,800,000 (shtatëdhjetë e nëntë milion e tetëqind mijë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. “SPARKLE 32” SH.P.K

L51327014R

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 98,970,000 (nëntëdhjetë e tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. “START CO” SH.P.K

L11614001S

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 96,767,000 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. “TIMAK” SH.P.K

L62030020B

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 84,345,000 (tetëdhjetë e katër milion e treqind e dyzetë e pesë mijë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “TIMAK” SH.P.K

L62030020B

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 84,345,000 (tetëdhjetë e katër milion e treqind e dyzetë e pesë mijë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

➤ Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.2, në të cilën është kërkuar “*Autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për llojin e mjetit të ofruar. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.*”

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “TIMAK” shpk, nuk ka paraqitur Autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për llojin e mjetit të ofruar dhe konkretisht për mjetet e ofertuar:

- ISUZU (pickup)
- ISUZU, GIGA 4x205 HP (zjarrëfikëse), prodhuar nga “Chengli Special Automobile Co”

KVO gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

➤ Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.5 në të cilën është kërkuar: “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjeteve të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së*”

Referuar Shtojces 7 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” të DST, sasia e mallit që kërkohet janë produktet si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Shuma
1	Kamion zjarrfikës	Copë	3
2	Automjet Pick UP “Nisja e parë”	Copë	3
3	Automjet Pick UP 4x4	Copë	4

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “TIMAK” shpk, nuk ka paraqitur katalog ose skedë teknike nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjeteve të ofruara për artikujt: **Automjet Pick UP “Nisja e parë” dhe “Automjet Pick UP 4x4”**.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar në këtë procedure prokurim rezulton se ofertuesi ka paraqitur katalog/skedë teknike per një automjet të ndryshem nga ai i kerkuar ne DST dhe specififikisht per automjetin ISUZU Pickup, lloji zjarrëfiksesë (pickup fire fighting truck).

➤ Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.1 në të cilën është kërkuar: “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

- *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
- *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Per përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik nga ngarkuar ne SPE faturat si më poshtë:

Nr.	Objekti	Data	Vlera
1	Bashkia Tirane Timak per zjarrfikese	27.11.2019	24,960,000
2	Bashkia Kukes blerje makine teknologjike	03.04.2020	9,225,000
3	BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD	17.12.2024	906,844
4	Zjarrfikese First Response Vehicle Ford Ranger XL	02.08.2023	10,431,120
5	Zjarrfikese Small Rescue Pumper Ford 1833 DC	02.08.2023	10,910,100
6	Zjarrfikese First Response Vehicle Ford Ranger Cha	04.12.2023	9,988,160
7	"NDREKAJ"	10.09.2024	7,200,000
8	Kontrate porosit me "Amex Healthcare"	31.01.2024	776,550 Euro

Kontratat e ngjashme, që të mund të konsiderohen të tilla, duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) Kontrata e furnizimit duhet të jetë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, në një vlerë sa 40% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe njëre prej këtyre elementeve e bën të pavlefshme eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga ofertuesi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga ofertuesi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit, Komisioni I Vleresimit të Ofertave, konstaton se kontratat me: “Bashkia Tirane per blerje zjarrfikese” dhe “Bashkia Kukes për blerje makine teknologjike” nuk përmbushin elementin kohe pasi janë realizuar jashtë afatit 3 (tre) vjeçar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ndërsa “Kontrate porositë me "Amex Healthcare" nuk është shoqëruar me faturë tatimore shitje dhe nuk mund të quhet kontratë e realizuar me sukses.

2. “SPARKLE 32” SH.P.K

L51327014R

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 98,970,000 (nëntëdhjetë e tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik “SPARKLE 32” shpk me nr. nipti L51327014R, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ligjor dhe teknik për të provuar që përmbush kërkesat e veçanta për kualifikim të përcaktuara në DST.

➤ Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.2.1, në të cilën është kërkuar “*Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të kontratës. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*”

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “SPARKLE 32” shpk, ka paraqitur vertitim për xhiron e tre viteve të fundit me Nr. T13352695, date 03.06.2025, ku rezulton se xhiro për vitet 2022-23-24, në të paktën 1(një) vit, është me e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të kontratës.

➤ Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.1 në të cilën është kërkuar: “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

- *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Kontratat e ngjashme, që të mund të konsiderohen të tilla, duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) Kontrata e furnizimit duhet të jetë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, në një vlerë sa 40% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe njëres prej këtyre elementeve e bën të pavlefshme eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga ofertuesi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga ofertuesi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit, Komisioni I Vleresimit të Ofertave, vëren se nga përllogaritja financiare e të gjitha faturave të paraqitura rezultojnë në një vlerë më të vogël se 39,904,000 lek pa t.v.sh (40 % të vlerës së fondit të limit të kërkuar në DST), si rrjedhojë nuk plotëson elementin vlerë.

➤ Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.5 në të cilën është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjeteve të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.

Ofertuesi nuk ka paraqitur katalog ose skedë teknike për “**PAJISJE HAPËSE-PRERËSE HIDRAULIKE ME BATERI**”, nga ku mund të verifikohet dhe të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së. Katalogu i pajisjeve është garancia teknike që pajisjet e ofruara janë të përshtatshme, të certifikuara dhe të krahasueshme me përputhshmërinë teknike të kërkuar në specifikimet teknike.

3. “ARTEO 2018” SH.P.K

L82523203F

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 87,600,000 (tetëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind mijë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik “ARTEO 2018” shpk me nr. nipti L82523203F, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ligjor dhe teknik për të provuar që përmbush kërkesat e veçanta për kualifikim të përcaktuara në DST.

a) Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.1 në të cilën është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës së

fondit limit të kontratës. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
- *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Per përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik nga ngarkuar ne SPE faturat si më poshtë:

Nr.	Faturë tatimore shitje per:	Data	Vlera
1	BASHKIA KORCE	17.10.2024 16:34:33	7,795,000
2	Agjensia e Shërbimeve Publike Urbane	10.02.2025 12:21:46	8,285,000
3	Agjensia e Shërbimeve Publike Urbane	04.03.2025 14:46:53	7,595,000
4	NDERMARRJA E SHERBIMEVE PUBLIKE FIER	10.06.2025 23:28:45	18,995,000
5	AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT	09.06.2023 10:00:03	8,895,000
6	BASHKIA LIBRAZHD	13.03.2025 09:01:09	2,068,500
7	Genci Duka	11.06.2025 23:39:04	5,850,000

Kontratat e ngjashme, që të mund të konsiderohen të tilla, duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) Kontrata e furnizimit duhet të jetë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, në një vlerë sa 40% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe njëre prej këtyre elementeve e bën të pavlefshme eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga ofertuesi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit, Komisioni I Vleresimit të Ofertave, konstaton se faturat lëshuar: Ndermarrjes së Shërbimeve Publike Fier, **me date 10.06.2025** dhe Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, **me date 09.06.2025**, nuk përmbushin elementin kohe pasi janë realizuar jashtë afatit 3 (tre) vjeçar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Këto fatura janë realizuar më vonë se data e publikimit të kontratës në SPE dhe kontretisht pas datës 12.05.2025.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga ofertuesi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit, Komisioni I Vleresimit të Ofertave, vëren se nga përlogaritja financiare e të gjitha faturave të paraqitura rezultojnë në një vlerë më të vogël se 39,904,000 lek pa t.v.sh (40 % të vlerës së fondit të limit të kërkuar në DST) duke mos plotësuar elementin vlerë të percaktuar në DST.

Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.5 në të cilën është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar ku të tregohen

dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjeteve të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.

Operatori Ekonomik ka paraqitur në SPE katalog/skedë teknike nga prodhuesi për automjetin zjarrfikës, por për dy automjetet Pick Up 4x4 , në asnjë rast nuk evidentohet lloji i automjetit dhe se katalogu/skeda teknike është nga prodhuesi.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “**MEKTRIN MOTORS**” shpk, me adresë: “*DURRES AUTOSTRADA KM.6 XHAFZ*”, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 79,800,000 (shtatëdhjetë e nëntë milion e tetëqind mijë) lekë pa tvsh është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR